



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (komision për dhënie mendimi)

Tiranë më, 9.11.2021

Dokument parlamentar

RAPORT **PËR** **PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”** (në parim)

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, në mbledhjet e tij të datës 3, 5, 8 dhe 9 nëntor 2020.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Alqi BLLAKO.

Komisioni zhvilloi 6 seanca për shqyrtimin në parim të projektbuxhetit ku u njoh me projektbuxhetin në tërësi nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, me projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me projektbuxhetin Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2022” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Komisioni u njoh me parashikimet e treguesit kryesorë të projektbuxhetit të vitit 2022 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë znj. Delina Ibrahimaj dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie. Mbledhja u zhvillua në datën 3 nëntor 2021.

Ministria Ibrahimaj, sqaroi se për shkak të tërmetit dhe më pas pandemisë globale të COVID 19, ekonomia u ngadalësua, por gjithsesi performoi më mirë sesa ishin edhe parashikimet e institucioneve financiare ndërkombëtare. Për vitin 2020, institucionet ndërkombëtare si FMN, Bankë Botërore, Komisioni Evropian, BERZH etj, parashikuan recesion deri në 9%, ndërkohë që u regjistrua zyrtarisht një recesion prej 3.96%.

Falë reformave dhe politikave të duhura që u ndërmorrën, ekonomia arriti të rikthehej në norma të larta rritje, ku specifikisht, për vitin 2022 parashikojmë një rritje të ekonomisë me 4.1%, duke mbajtur një nivel mesatar prej mbi 4% për vitet pasuese 2023 dhe 2024. Ekonomia shqiptare ka pasur një rekuperim të shpejtë në gjashtëmuorin e parë të 2021. Për këtë periudhë, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) ka shënuar rritje prej rreth 11.9 përqind krahasuar me një vit më pare.

Konkretisht, PBB për gjashtëmuorin e parë të vitit 2021 ka shënuar rritje prej rreth 11.9 për qind krahasuar me gjashtëmuorin e parë të vitit 2020. Ky rikuperim është prezent në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë dhe mbështetet kryesisht në:

- Reduktimin e kufizimeve pas rënies së infektiveve ku një rol kyç ka pasur edhe procesi vaksinimit,
- Rritja e besimit të biznesit e konsumatorit,
- Përmirësimi i ekonomive partnere, si dhe
- Politikat mbështetëse fiskale e monetare, të cilat kanë sjellë rritje të konsumit të familjeve, të investimeve publike e private, si dhe të eksporteve.

Projektbuxheti 2022 ka si objektiv primar konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike, pas përballimit me sukses të dy fatkeqësive natyrore, që goditën vendin tonë në mënyrë të njëpasnjëshme. Ky objektiv madhor bazohet në pritshmëritë pozitive të Qeverisë për një rritje ekonomike domethënëse në vitin 2021 prej 7.6%, duke lënë pas recesionin ekonomik të vitit 2020.

Ky projektbuxhet synon stabilitet, rimëkëmbje ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik të Shqipërisë. Konkretisht, ky buxhet synon:

- Vijimin e reformave strukturore për të garantuar rritje ekonomike dhe punësim;
- Mbeshtetjen e shtresave në nevojë;
- Rritjen e produktivitetit;
- Forcimin e shtetit ligjor;
- Digjitalizimin e ekonomisë; si dhe
- Rritjen e investimeve kyçe në infrastrukturë.

- ***Të ardhurat***

Programimi i të ardhurave buxhetore për vitin 2022 mbështet synimet e qeverisë në lidhje me rimëkëmbjen ekonomike dhe me mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Kjo mendohet të arrihet nëpërmjet përmirësimit të administrimit fiskal dhe minimizimit të informalitetit.

Të ardhurat totale të buxhetit të shtetit për vitin 2022 parashikohen të arrijnë 536.8 miliard lekë, nga këto, të ardhurat tatimore 500.2 miliardë lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat 360.5 miliardë lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen 111 miliardë lekë.

Në programimin e të ardhurave nga tatimet dhe doganat për vitin 2022, janë marrë në konsideratë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet, si dhe performanca janar – gusht 2021 e realizimit të të ardhurave tatimore dhe doganore.

- **Shpenzimet**

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2022 është planifikuar 637.7 miliardë lekë, pra 34.1% e PBB-së.

Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, arsimit dhe kujdesit ndaj brezave, duke filluar me programet specifike për mirërritjen dhe shkollimin e fëmijëve, aftësimin dhe punësimin e të rinjve, si dhe një mbështetje më të madhe financiare për shtresat në nevojë dhe moshën e tretë.

Investimet Publike parashikohen në masën 119.1 miliardë lekë, pra 6.4% e PBB-së, përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 20 miliardë lekë si dhe transfertën kapitale për fondin e shpronësimeve me 1,8 miliardë lekë. Në planifikimin e investimeve për vitin 2022 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm.

- **Defiçiti buxhetor**

Defiçiti buxhetor për vitin 2022 planifikohet të jetë në nivelin 5.4% të PBB-së. Pavarësisht nivelit relativisht të lartë që vjen si pasojë e efekteve negative të tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, deficieti buxhetor vijon të mbështesë ekskluzivisht financimin e investimeve publike. Në fund të vitit 2024, niveli i deficitit buxhetor parashikohet të ulet në 2.8% të PBB-së duke përmbushur kështu objektivin madhor të qeverisë për uljen graduale të stokut të borxhit publik.

- **Borxhi publik**

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2021, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus plotësimin e nevojave për huamarrje në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë pas situatës së krijuar nga tërmeti i muajit nëntor 2019 dhe përhapjes së pandemisë Covid-19, duke mbajtur në konsideratë përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostos.

Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet rifinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të realizohet huamarrja e re e planifikuar.

Në tregun e huaj, burimet kryesore të huamarrjes do të jenë:

- huatë me terma të buta ose pjesërisht të buta, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria;
- huatë në formën e mbështetjes buxhetore nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur qeverinë për pandeminë COVID-19 dhe për reformat e politikave zhvillimore të vendit;
- Eurobondi që sapo u miratua dhe synohet të emetohet brenda vitit 2021.

- **Buxheti vendor**

Mbështetja që ka dhënë qeveria për njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet reformave të ndërmarra, por edhe rritja e konsiderueshme e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ka bërë të mundur që pesha e buxhetit vendor të rritet në 3.2% të PBB-së në vitin 2022.

Krjimi i hapsirës së nevojshme fiskale dhe kapaciteteve njerëzore për zbatimin e funksioneve ligjore është një ndër synimet bazë të forcimit të rolit të pushtetit vendor. Financat vendore në vite kanë pësuar rritje jo vetëm të burimit të të ardhurave të veta por gjithashtu edhe të financimit të plotë të funksioneve të transferuara nga pushteti qendror.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në mbledhjen e datës 5 nëntor 2021. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministria Znj. Frida Krifca. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Buxheti i vitit 2022 për bujqësinë dhe zhvillimin rural vjen me plot risi që do të ndikojnë direkt në përmirësimin e zinxhirit të prodhimit nga ferma në tryezat tona dhe në eksport.

Prioritetet për bujqësië janë rritja e eksporteve, garantimi i sigurisë ushqimore, turizmi rural, digjitalizimi dhe inovacioni, peshkimi.

Këto prioritete do të realizohen me mbështetjen më të lartë të dhënë ndonjëherë në bujqësi prej 7.1 miliardë lekë fonde në dispozicion vetëm për financimin e zhvillimit rural ndër të cilat 3.2 miliardë lekë përbëjnë mbështetje të drejtëpërdrejtë për rreth 40-50 mijë fermerë dhe 2.2 miliardë lekë për Programin IPARD për realizimin e rreth 200 investimeve në proces, si dhe rreth 400 milionë lekë mbështetje për *start up*-e në bujqësi dhe për projekte të tjera mbështetjeje në bujqësi.

Rritja e eksporteve synohet nëpërmjet nxitjes së produktivitetit duke mbështetur dhe financuar rritjen e sipërfaqes së serrave, fuqizimin e fermave të mëdha, forcimin e agropërpunimit, rritjen e mekanizimit, si dhe teknologjitë inovative.

Nëpërmjet këtij buxheti do të ketë incentiva për të çuar kapital dhe investime në fshatrat e Shqipërisë nëpërmjet investimeve në infrastrukturën dhe shërbimet e turizmit rural me fokus të posaçëm gratë, të rinjtë dhe shqiptarët që jetojnë jashtë dhe duan të investojnë në vendlindjen e tyre në fshat. Do të ketë mbështetje për inovacionin dhe digjitalizimin duke inkurajuar të rinjtë të ndërtojnë *start up*-e në shërbim të bujqësisë së zhvilluar.

Ndër objektivat e këtij buxheti është edhe financimi për fara dhe fidanë të kulturave prioritare të eksportit, si dhe nxitja e formalizimit të industrisë së qumështit, duke synuar njëherazi edhe rritjen e cilësisë së përpunimit nëpërmjet financimit për litër, por dhe inkurajimit të të rinjve që të angazhohen në fushën e blegtorisë dhe përcimit të traditës blegtorale për barinjtë.

Do të vijojë skema e naftës pa akcizë, e cila jo vetëm do të mbështesë 30,000 fermerë por do të vijojë të lehtësohet dhe do të përfshijë këtë vit edhe kulturën e ullirit.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mësipërme sipas programeve të mëposhtme:

- **Zhvillimi rural dhe mështetja për fermerin**

Programi Zhvillimi Rural, ku përfshihen edhe skemat mbështetëse të fermerëve me subvencione dhe përfshihet edhe shpërndarja e naftës pa detyrime fiskale për përdorim në bujqësi për fermerët, duke subvencionuar me 1 miliardë lekë këtë skemë.

- *Mbështetja nëpërmjet Skemës Kombëtare*

Mbështetja nëpërmjet Skemës Kombëtare me 3.2 miliardë lekë, ka dyfishim buxheti dhe do të përfshijë mbështetjen për prodhimin e qumështit, prodhimin primar si perimet në serra, bimët mjekësore dhe aromatike, fermat organike, etj, si dhe ndërtim dhe rritje të sipërfaqes së serave, pika grumbullimi, akuakulturë dhe inovacione në teknologji. Përfitues nga këto masa mbështetëse do të jenë 40-50 mijë fermerë. Mbështetja nëpërmjet Skemës së naftës falas për punimet e mekanizuara me 1.04 miliardë lekë, pra 4% nga më tepër nga viti 2021. Nga kjo skemë në 2021 përfituan mbi 19 mijë fermerë dhe numri i përfituesve parashikohet të arrijë në 30 mijë fermerë.

- *Mbështetja nëpërmjet Programit IPARD*

Mbështetja nëpërmjet Programit IPARD me 2.6 miliardë lekë financim i huaj dhe bashkëfinancim ku përfitues janë 200 subjekte.

Projekte për Bujqësi të digjitalizuar me vlerë rreth 103 milionë lekë që do të ndihmojnë në ngritjen e regjistrave të fermës, të sistemeve të aplikimeve online duke ulur barrën për aplikantët dhe rritur transparencën dhe kohën e procesimit të aplikimeve për mbështetje.

Një tjetër objektiv është Regjistri i Digjitalizuar i fermës, me vlerë 40 milionë lekë, për regjistrimin e fermerëve, përthithjen e fondeve nga fermerët, përmes buxhetit të shtetit, Programit IPARD dhe donatorëve të tjerë.

- *Bashkëfinancim për Mbështetjen me Kredi Rurale*

Me qëllim lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit në bashkëpunim me BERZH-in nëpërmjet fondit të garancisë ku do të garantojë kontributin e qeverisë me 36 milionë euro. Synimi është gjenerimi i 180 milionë euro në vlerë kredie për sektorin bujqësor dhe rural në vend.

Deri në fund të shtatorit 2021, është disbursuar një numër prej 6,125 kredish për një vlerë prej 71.6 milionë euro.

Parashikohet 200 milionë lekë në formën e mbështetjes me grante për *start up*-e në bujqësi dhe peshkim me fondin e garancisë së *Rural Credit Guarantee Foundation* së KFW-së, në masën 50% nga buxheti i shtetit dhe 50% investimi privat, krahas fondeve prej rreth 5 milionë euro që vetë Fondi do të vendosë për sektorin e bujqësisë dhe peshkimit. Përfitues mund të jenë 500-1000 fermerë.

- **Siguria Ushqimore**

Në vitin 2022 do të jetë buxheti më të lartë për sigurinë ushqimore me 2.3 miliardë lekë.

Me këtë buxhet synohet rritje në sigurinë ushqimore drejt standardeve europiane me laboratorë modernë dhe trajnim kapilar të burimeve njerëzore. Për këtë do të pajisen 120 grupet e kontrollit të AKU me teknologji për kontrole eficiente dhe cilësore, si dhe do të matrikullohet, vaksinohet dhe gjurmohet i gjithë kapaciteti blegtoral si pasuri kombëtare.

Nëpërmjet forcimit të dy autoriteteve kontrolluese që mbulojnë tashmë të gjithë spektrin e kontrollit për ushqimin, veterinarinë dhe bimët do të sigurohet një efektivitet kontrolli me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit shqiptar si dhe eksporteve shqiptare. Frekuenca dhe cilësia e kontrollit, do të jenë prioritet, jo vetëm për të siguruar konsumatorin por edhe për të ofruar një qasje bashkëpunimi me biznesin për të rritur ndërgjegjësimin e tyre në raport me plotësimin e standarteve.

Rritja e cilësisë së kontrollit në lidhje me produkteve shtazore (mishit) duke vënë në eficensë të plotë kontrollin nga kafsha në fermë tek thertoret, duke ndjekur regjistrimin, statusin shëndetësor dhe rregjistrimin e kafshëve.

Synohet gjithashtu, forcimi i kapaciteteve inspektuese me njohuri dhe praktika për të siguruar një kontroll efikas nga ferma tek produkti final me qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit por edhe garantimin e eksportit të produkteve “Made in Albania”.

Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike për të siguruar konfirmim të besueshëm të treguesve të sigurisë ushqimore në përputhje me kërkesat evropiane, nëpërmjet rritjes së numrit të testeve laboratorike të

akredituara është një tjetër objektiv. Këto laboratore shërbejnë edhe si “Garanci “ për eksportet Shqiptare drejt BE-së.

Tjetër objektiv i këtij buxheti është edhe forcimi i sistemit të gjurmueshmërisë nga fara -bima - trajtimi me produktet e mbrojtjes së bimëve deri tek produkti që i ofrohet konsumatorit; nga lindja e kafshës - ushqyerja - trajtimi me produkte veterinarë deri tek produkti final – kjo nëpërmjet krijimit të regjistrave të fermerëve që evidentojnë të gjithë fazat e zinxhirit përfshirë edhe përdorimin e pesticideve dhe antibiotikëve.

Buxheti 2022 do të mundësojë gjithashtu fillimin e punës për krijimin e librit të fermerit, si një mekanizëm i pagabueshëm në shërbim të prodhimit dhe eksporteve.

- **Peshkimi**

Programi Mbështetje për peshkimin me një buxhet prej 702 milionë lekë synohet të kryhen investime si:

- Blerja e bankinave lundruese, të cilat mundësojnë rritjen e kapaciteteve ankoruese dhe ankorimin e rreth 150 anijeve peshkimi.
- Transformimi i Strukturës frigoriferike në një merkato të tregtimit me shumicë, si pjesë e programit të ministrisë për ndërtimin e merkatove në 4 portet e peshkimit.

- **Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit**

Buxheti i vitit 2022 për këtë program shkon në 1,7 miliardë dhe me këtë buxhet do të vazhdojnë ndërhyrjet me investime në zonat më problematike. Gjatë vitit 2022 është parashikuar:

- mbështetje e vazhdueshme e rritjes së prodhimit bujqësor nëpërmjet plotësimit të nevojave të fermerëve për ujitje, sigurimin e kullimit dhe zvogëlimin e rrezikut nga përmytjet;
- Rehabilitim dhe modernizim të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Rreth 700 milionë lekë janë projekte të angazhuara dhe investohet në vazhdimësi, ndërsa rreth 300 milionë lekë është buxheti i dedikuar për projekte të reja.

Investimet e parashikuara në rehabilitimin e mirëmbajtjen e kanaleve kryesorë ujitës janë në funksion të investimeve të kryera deri tani nga bashkitë, apo parakusht për ndërhyrjet që do të planifikohen në vijim. Ndërkohë që, rreth 200 milionë lekë financim janë shtesë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, i pa përfshirë në buxhetin total, për mbrojtjen nga përmytja për 6 objekte të konsideruar si prioritare, që aktualisht janë në proces prokurimi nga kjo agjenci.

Në ujitje ka projekte të reja rehabilitimi të kanaleve kryesorë ujitës, ku përmirësohet ujitja në rreth 10,000 ha, duke furnizuar me ujë kanalet sekondarë në administrim të disa bashkive.

Në sigurinë e digave parashikohet përgatitja e projekteve të zbatimit të sistemeve të monitorimit dhe alarmit të digave, si dhe përgatitja e hartave të përmytjeve dhe batimetrive.

Në mbrojtjen nga përmytja parashikohen 14 objekte, 6 në vazhdim dhe 8 të rija, për rehabilitimin/ndërtimin e rreth 12 km argjinatura më të ekspozuara nga rreziku i përmytjeve lumore, si dhe përfundon rehabilitimi i Argjinaturës së Selevcit, në Vlorë, në një gjatësi prej rreth 5 km, që është dhe në funksion të mbrojtjes nga përmytja të fushës së Akërnisë, ku do të ndërtohet Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës.

Në hidrovore parashikohet përfundimi i rikonstruksionit të hidrovorit të Karavastasë në Divjakë që shërben për kullimin e rreth 7,000 ha tokë bujqësore, dhe po vlersohen dhe ndërhyrje të tjera për të rritur sigurinë e kullimit.

- **Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor**

Qëllimi i këtij programi është përmirësimi i njohurive të fermerëve dhe agrobizneseve duke ofruar asistencë teknike falas me qëllim përmirësimin e produktivitetit bujqësor.

- Rritjen e aftësisë thithëse të financimeve nga Skemat Kombëtare Mbështetëse.
- Informimi dhe asistimi i 72,000 fermerëve nga strukturat e ekstensionit në 4 AREB-et;
- Asistimi i rreth 35,000 fermerëve aplikues në Skemat kombëtare dhe Skemën e naftës;
- Ofrimi i rreth 16 kartave dhe paketave teknologjike me elementë të përmirësuar;
- Trajnimi i 225 specialistëve të stafit të 4 AREB-ve çdo vit ;
- Informimi dhe trajnimi i rreth 1,150 grave fermere.

- **Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore**

Me anë të këtij programi parashikohet që:

- Për vitin 2022, është parashikuar shtimi i informacionit digjital, duke e çuar sipërfaqen totale në rreth 434 mijë ha, shtrirë në 159 njësi administrative, 39 bashki dhe në 10 qarqe.
- Kontributet e LIS mundësojnë rritjen më cilësore të produktivitetit të bujqësisë në vend, duke ndihmuar në rritjen e eksporteve bujqësore shqiptare.
- LIS i integruar në WEB-GIS mundëson përmirësimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të ofruara nga Ministria për fermerët dhe gjithë të interesuarit e tjerë.

- **Diskutimi në Komision**

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2022 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u përqëndruan kryesisht në:

- funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture nga pushteti vendor në zona të ndryshme, si dhe mbështetja e këtyre projekteve me investime. Mungon lista e këtyre objekteve në investimet e pushtetit vendor.
- funksionimin e skemës së mbështetjes për fermerët dhe ndërtimin e tregjeve për grumbullimin e produkteve bujqësore;
- funksionimin e skemës së mbështetjes për fermerët për heqjen e taksës së karbonit për karburantit që përdoret në bujqësi, zgjerimi i kësaj skeme, si dhe përmirësimi i zbatimit të saj, si dhe lehtësimi i procedurave që fermerët të përfitojnë nga skemat e mbështetjes së fermerëve;
- peshkimin dhe mbështetjen e tij, e cila është ulur për këtë vit;
- forcimin e kontrollit për sigurinë ushqimore në të gjitha aspektet e saj dhe forcimin e institucioneve që lidhen me të, dhe mbështetja me laboratorë cilësorë dhe të kohës;
- këshillimin e fermerëve dhe mbështetjen e tij në mënyrë që të orientohet sa më mirë në veprimtarinë e tij, duke qenë se këshilluesit janë të paktë në raport me numrin e fermerëve;
- krijimi i skemave të sigurimit në bujqësi në mënyrë që dëmi të mos i mbetet i gjithi fermerit;
- mbështetja për blegtorinë dhe fermat blegtorale;
- nxitjen dhe mbështetjen e agropërpunuesve me qëllim rritjen e vlerës së produktit shqiptar që eksportohet, si dhe ndikim në ekonominë e vendit;
- mbështetja e fermerëve që merren me bimët medicinale;
- ndikimi i paketës fiskale e cila prek disa nga produktet që ndikojnë në bujqësi dhe agropërpunim; etj.

Në përgjigje të shqetësimeve të ngritura nga deputetët, Ministria Znj. Krifca sqaroi se problematikat në bujqësi ekzistojnë dhe se fragmentarizimi i tokës vazhdon të mbetet problemi më i madh në bujqësinë shqiptare, e cila nuk lejon rritjen dhe funksionimin e fermave të mirëfillta të mëdha. Gjithashtu, ajo sqaroi se:

- për vitin 2022 nuk janë parashikuar investime për objektet e ujitjes në administrim të bashkive, pasi janë vlerësuar më prioritarë dhe me impakt më të madh ndërhyrjet në objekte që administrohen nga Ministria;
- rritja e eksporteve synohet të arrihet nëpërmjet nxitjes së produktivitetit duke mbështetur dhe financuar rritjen e sipërfaqes së serrave, fuqizimin e fermave të mëdha, forcimin e agropërpunimit, rritjen e mekanizimit, si dhe teknologjitë inovative. Pikat e grumbullimit janë me standarde shumë të larta;
- TVSH-ja e rimbursueshme ka rezultuar që nuk ka vajtur tek fermeri. Sot financohet për të rritur kapacitetet që të nxjerrin produkte të përpunuara, madje dhe për eksport;
- Në vitin 2022 synohet të aksesohen dyfishi i fondeve të BE-së;
- Do të synohet incentivimi i të rinjve për të ushtruar zanatin e bariut, si dhe mbështetje për fermat blegtorale;
- Sa i përket Këshillimit, fermerët do të incentivohen në mënyrë direkte për të rritur produktivitetin nëpërmjet orientimit drejt kulturave të kërkuara nga tregjet ndërkombëtare dhe me mekanizim, si dhe mbështetje të drejtpërdrejtë me naftë pa akcizë duke ndikuar në rritjen e sipërfaqes së prodhuar;
- Peshkimi do të mbështetet për përmirësimin e infrastrukturës së flotës së tyre dhe me investime të shtuara në peshkim dhe akuakulturë;

- Siguria ushqimore është prioritet i qeverisë shqiptare ndaj do të investohet në kapacitete, në përmirësimin e analizave dhe kontrollove, në gjurmueshmëri, higjenë dhe paketim;
- Agropërpunuesit do të mbështeten për fuqizimin e kapaciteteve dhe linjave përpunuese dhe përmirësimin e infrastrukturës duke shtuar vlerën e produktit primar në vend.

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në mbledhjen e datës 9 nëntor 2021. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri Znj. Mirela Kumbaro dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë çka është unike në vend.

Për fushën e Mjedisit, synohet sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimi i kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Në total buxheti i kësaj ministrie është rreth 2.92 miliardë lekë dhe ka një rritje me rreth 22% në krahasim me buxhetin e vitit 2021.

- **Zhvillimi i turizmit**

Në fushën e Turizmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë çka është unike në vendin tonë.

Ky sektor ka pësuar një goditjen më të rëndë nga pandemia e Covid 19 dhe për vitin 2020 mbijetesa e tij është përballuar vetëm nga shqiptarët qofshin ata vendas apo të rajonit, ndërkohë që kjo kohë shërbeu edhe për të promovuar potencialin turistik të Shqipërisë tek vendasit. Kjo bëri që operatorët turistikë vendas të krijojnë paketa turistike të diversifikuara që prekin një gamë të gjerë të llojeve të turizmit.

Gjithashtu, janë një sërë aksesh të reja në infrastrukturë që e lehtësojnë lëvizjen e njerëzve duke favorizuar kështu edhe turizmin, duke krijuar edhe unaza të reja me destinacione turistike.

Ka pasur një rritje të interesit për turizmin rural gjatë kësaj kohe, ndërkohë që edhe programi i “Rilindjes urbane” ka filluar të japë efektin e vet në krijimin e destinacioneve të reja turistike.

Ndër projektet e reja është edhe ai i rikualifikimit të pikave hyrëse dhe dalëse me një investim prej 24.24 milionë lekësh, kjo në pikat ku dhe fluksi i hyrjes së turistëve është më i madh.

Ekoturizmi dhe agroturizmi është një tjetër prioritet i Ministrisë së Turizmit dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet politikave dhe ligjëbërjes, gjë që ka sjellë një rezultat shumë të mirë në këtë sektor. Mbetet detyrë krijimi i ofertave të tilla që ky lloj turizmi të jetë si i shtrirë në territor ashtu edhe gjatë gjithë vitit.

- **Mjedisi**

Për fushën e Mjedisit, synohet sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Prioritet për mjedisin janë programe që shkojnë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të tij.

Këtë vit ka pasur një rritje të zonave të mbrojtura natyrore, të cilat shkojnë në rreth 21 % e territorit.

Investimet fokusohen në një sërë ekoparqesh siç janë ai i Syrit të Kaltër, Vjosës dhe Ulzës, të cilat përveç efektit në mjedis do të sjellin efekt edhe në turizmin e zonës.

Objektivat kryesore për mjedisin fokusohen në:

- Edukimin mjedisor për të rinjtë;
- Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit në vitin 2024 sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me pushtetin vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

Fokusi do të jetë tek menaxhimi i mbetjeve si dhe monitorimi i këtij procesi. Orientimi i menaxhimit të tyre drejt riciklimit është esencial për një mjedis të pastër dhe një menaxhim sa më të mirë të tyre. Ka bashki që janë në fillim të këtij procesi por ka edhe prej atyre që nuk e kanë nisur fare. Akoma ka venddepozitime informale të mbetjeve, të cilat do të trajtohen e sistemohen.

- ***Diskutimet në Komision***

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2022 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, u përqëndruan kryesisht tek:

- ambiciet dhe pritshmëritë që ka ekonomia shqiptare nga sektori i turizmit;
- bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen me infrastrukturë rrugore, ujësjellës – kanalizime, energji, e zonave me përparësi turizmin dhe zonat që synohen të promovohen si destinacione turistike, si dhe disiplinimi e trajtimi i ujërave të ndotura që derdhen në dete e lumenj;
- mbrojtja e mjedisit dhe promovimi e ndërjegjësimi për të;
- menaxhimi i mbetjeve në qarqe të caktuara dhe tarifimi i ndryshëm në landfille të ndryshme;
- incentivimi i agroturizmit në zona të reja dhe mbështetja me fonde;
- ecuria e administrimit të pyjeve, monitorimi i moratoriumit dhe nevoja për lëndë drusore në disa zona të caktuara, si dhe monitorimi i tregut të druve të zjarrit;
- strukturat e mbikqyrjes së pyjeve dhe pyllëzimet e reja apo strategji për këtë, dhe bashkëpunimi me bashkitë për përmirësimin e menaxhimit të kësaj pasurie kombëtare;

- investimi në infrastrukturë, menaxhimi dhe mbikqyrja e zonave të mbrojtura dhe promovimin e tyre si atraksione turistike dhe ndërhyja e nevojshme në disa prej tyre;
- disiplinimi i lejeve të shfrytëzimit të plazheve;

Deputetët, u shprehën që buxheti i akorduar për turizmin dhe mjedisin është modest dhe nuk reflekton mbështetjen që duhet të kenë këta dy sektorë.

Ministria Kumbaro, iu përgjigj shqetësimeve të deputetëve duke dhënë detaje në lidhje me çështjet e ngritura prej tyre.

Gjithashtu, në përfundim ajo kërkoi mbështetjen e tyre për disa rregullime të brendshme buxhetore të cilat do sillnin një efektivitet më të mirë të fondeve të alokuara në përmbushje të misionit të kësaj Ministrie në fushën e turizmit dhe mjedisit.

Konkretisht ndryshimet e propozuara janë si më poshtë:

1. Në llogarinë 604 (Transferta korrente të brendshme) në programin e mjedisit, fondi prej 500 milion lekë kërkojmë të zbritet nga buxheti i MTM dhe të kalojë në fondin rezervë të buxhetit të shtetit.
2. Nga përlllogaritjet për zërin paga e sigurime shoqërore, mbështetur në numrin e punonjësve sipas organikës së MTM, kërkojmë shtesë fondi prej 20 milion lekë në llogarinë 600 (Paga) në programin Administrimi i Pyjeve.
3. Brenda tavaneve të programeve buxhetore për MTM propozojmë ndryshimet si më poshtë:
 - Në shpenzimet korrente, në programin “Mbrojtja e Mjedisit”, në llogarine ekonomike 602 (mallra dhe shërbime) të zbriten 18 milion lekë dhe të shtohen në programin “Zhvillimi i Turizmit” në llogarinë ekonomike 602 , 18 milion lekë.
 - Në shpenzimet kapitale, në programin “Administrimi i Pyjeve”, nga kapitulli 4 (TVSH) të zbriten 40 milion lekë dhe t’i shtohen kapitullit 1 (Investim).
 - Në shpenzimet kapitale, në programin “Zhvillimi i Turizmit”, nga kapitulli 3 (kosto lokale) të zbriten 4,5 milion lekë, nga kapitulli 4 (TVSH) të zbriten 15 milion lekë, për t’u shtuar në kapitullin 1 (investime), në total 19.5 milion lekë.
 - Në shpenzimet kapitale në programin “Mbrojtja e Mjedisit”, nga kapitulli 3 (kosto lokale) të zbriten 15 milion lekë, nga kapitulli 4 (TVSH) të zbriten 15 milion lekë, për t’u shtuar në kapitullin 1 (investime), në total 30 milion lekë.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në mbledhjen e datës 9 nëntor 2020. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministria Znj. Belinda Balluku dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Ministria Balluku u shpreh se Buxheti i vitit 2022 i akordon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë një buxhet total në vlerën 47.4 miliard lekë, nga të cilat:

- shpenzime korrente në vlerën 5 miliard lekë
- shpenzime kapitale në vlerën 42.4 miliard lekë, të cilat sigurohen nga financimi i brendshëm në vlerën 25.4 miliard lekë dhe financim i huaj në vlerën 17 miliard lekë.

Për vitin 2022 ka një pakësim prej 1.9 miliard lekë krahasuar me ligjin e buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësohet se mbulon vetëm 71 % të nevojave reale.

Orientimet kryesore të buxhetit 2022 e në vazhdim, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë:

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjive Sektoriale, ky institucion synon të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit, të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: një portofoli të investimeve publike, si dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;
- Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet vazhdimit të ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese.

• **Energjia**

Ky program konsiston në krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillimin e politikave dhe strategjive për një ecuri të qëndrueshme të sektorit të energjisë, në zbatim të programit dhe prioriteteve të qeverisë.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2022, tavanet për këtë program janë rritur në total për 223.4 milion lekë nga të cilat;

- një pakësim të shpenzimeve korrente në vlerën 46.6 milion lekë;
- një pakësim të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm në vlerën 50 milion lekë;
- një rritje të shpenzimeve kapitale me financim të huaj në vlerën 320 milion lekë.

Projektligji i buxhetit 2022 siguron mbështetje buxhetore për projektet prioritarë me financim të brendshëm që përfundojnë në vitin 2021 ku dhe përmendim:

- Projekt pilot për sistemin e ndricimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave "2km Smart City - rruga e Energjisë së Pastër";
 - Standardet e ndriçimit Urban dhe Rrugor në Republikën e Shqipërisë;
 - Studimi i plotë i fisibilitetit për vendosjen e Kullave të Karikimit për makinat elektrike në Republikën e Shqipërisë;
 - Projekt ide mbi Elektrifikimin e linjave të transportit urban dhe ndërqytetas në Bashkitë Tiranë, Vlorë, Durrës;
 - Projekt Pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza;
 - Projekt Pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e furnizimit me ujë;
 - TVSH dhe Kosto lokale për projektet me financim të huaj.
- **Infrastruktura**

Transporti rrugor

Prioritetet mbi të cilën është hartuar projektbuxheti afatmesëm 2022 -2024 konsistojnë në:

- 1- Mbështetjen buxhetore për vazhdimin e financimit të akseve rrugore prioritare në ndërtim, si dhe projekteve koncensionare që po implementohen në infrastrukturën rrugore;
- 2- Mbështetjen buxhetore për financimin e mirëmbajtjes së akseve rrugore të ndërtuara;
- 3- Mbështetjen buxhetore për projekte të reja të infrastrukturës rrugore;
- 4- Mbështetje buxhetore për kryerjen e procedurave të shpronësimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme që mundëson vazhdimin e projekteve ndërtimore;
- 5- Mbështetjen buxhetore për projektet e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore;
- 6- Mbështetje buxhetore i zërit TVSH dhe Kosto lokale për të gjitha projektet me financim të huaj;
- 7- Moskrijimi i detyrimeve të prapambetura.

Projektligji “Për Buxhetin e vitit 2022”, në programin e transportit rrugor ka një pakësim prej 2.2 miliard lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2021. Ky projektligj mbulon rreth 77% të nevojave reale të kërkuara për këtë program, për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale së bashku.

Ministria Balluku, bëri një paraqitje të detajuar të objekteve në zhvillim dhe atyre të reja, duke detajuar edhe financimet e tyre me kapital të huaj apo të brendshëm.

Transporti ajror

Prioriteti në këtë program është financimi i kontratës së Shërbimeve inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP “Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit”

Në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” shpenzimet korrente parashikohen 21.1 milion lekë për OKIA dhe shpenzime kapitale me financim të brendshëm në vlerën 71.2 milion lekë që mbulojnë politikat ekzistuese që përbëhen nga projektet:

- Shërbimet inxhinierike të pavarura për zbatimin e Kontratës Koncesionare/PPP “Për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e Aeroportit të Kukësit, në vlerën 70.2 milion lekë;
- Blerje paisje operationale, në vlerën 1 milion lekë.

Ky program buxhetor nuk ka mbulim me financim të huaj.

Transporti Detar

Ky program mbulon me financim projekte të investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore, sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2022 ka rritje të tavanit buxhetor me 39.4 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2021. Kjo rritje konsiston në:

- rritjen e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm me 30 milion lekë;
- rritjen e shpenzimeve kapitale me financim të huaj me 10 milion lekë;
- pakësim të shpenzimeve korrente për 600 mijë lekë.

Ndër projektet prioritare që do të fillojnë të zhvillohen është “Projektimi dhe ndërtimi i Portit të Integruar Triport Vlorë”, realizimi i të cilit nuk kërkon mbështetje buxhetore në programin buxhetor afatmesëm 2022 -2024.

Nëpërmjet një masterplani të detajuar, Triporti parashikohet të kthehet në një port miks ku do të akomodohet porti aktual i peshkimit, shërbimet e përpunimit të mallrave dhe transporti i pasagjerëve dhe automjeteve.

Transporti Hekurudhor

Ky program ka për qëllim Integrimin e Sistemit Hekurudhor Shqiptar me atë Rajonal dhe Evropian nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave zhvilluese në fushën e infrastrukturës dhe mjeteve të transportit hekurudhor.

Projektet bazë për realizimin e qëllimit të programit dhe të objektivave për periudhën afatmesme 2022 -2024 konsistojnë në:

- 1- Rikonstruksioni i segmentit Tiranë-Durrës, ndërtimi i linjës së re Tiranë – Rinas;
- 2- Studime fizibiliteti dhe projekte zbatimi për segmente ekzistuese dhe për projekte të reja hekurudhore;
- 3- Vazhdimin e financimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore dhe mjeteve.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2022 ka rritje të tavanit buxhetor me 648 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2021. Kjo rritje konsiston në:

- rritje me 558 milion lekë të shpenzimeve për investime nga financimi i huaj;

- rritje me 100 milion lekë të investimeve me financim të brendshëm;
- pakësimin prej 10 milion lekë të shpenzimeve korrente.

Në shpenzimet korrente peshën kryesore e zë subvencioni i Hekurudhës Shqiptare në vlerën 397 milion lekë.

Projektligji i buxhetit 2022, siguron mbështetje buxhetore për projektin kryesor të këtij programi “Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroportin e Rinasit”, ku financimi i brendshëm mbulon shpenzimet kapitale për shpronësime, TVSH e kosto lokale, ndërsa financimi i huaj (kredi dhe grant) mbulon ndërtimin e linjës.

- **Mbetjet urbane**

Qëllimi i programit të “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane” është:

- Ngritja e një sistemi modern dhe efektiv të menaxhimit të integruar të mbetjeve që kontribuon, mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut, dhe mbështet përdorimin racional të burimeve natyrore.
- Për një sigurim të menaxhimit gjithëpërfshirës dhe strategjik për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve të ngurta shtëpiake.

Znj. Balluku listoi projektet me financim të brendshëm dhe ato me financim të huaj.

- **Furnizim me ujë dhe kanalizime**

Ky program financon projekte të hartuara në përputhje me prioritetet e qeverisë për reformën e ujit, mbështetur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Strategjinë Sektoriale, Programin Kombëtar Sektorial, grupi “Uji për njerëz” dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Programi mbështet realizimin e objektivave të mëposhtëm:

- Furnizimin me ujë të zonave urbane,
- Zgjerimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave bregdetare,
- Mbulimin e kostos operative dhe rritja e performances se ndërmarrjeve,
- Mbulimin me kanalizime dhe ITUN.

Në programin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime, si një ndër prioritet e qeverisë për periudhën 2022-2024, projektligji siguron një rritje të mbështetjes buxhetore në këtë program, krahasuar me ligjin e buxhetit 2021 prej 3.35 miliard lekë.

Ky projektligj mbulon 85% të nevojave reale të kërkuara nga MIE e konkretisht:

- Shpenzimet korrente rezultojnë me një ulje prej 25.6 milion lekë;

- Shpenzimet kapitale rezultojnë me një rritje prej 3.59 miliard lekë nga të cilat shpenzimet kapitale me financim të huaj rriten me 916 milione lekë dhe shpenzimet kapitale me financim të brendshëm rriten me 2.67 miliard lekë;

- **Mbështetje për Industrinë**

Për këtë program, në zërin e shpenzimeve korrente janë planifikuar fonde për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzime operative për institucionet buxhetore :

- Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial
- Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme Elbasan
- Konservime

Projektligji “Për Buxhetin e vitit 2022” mbulon 100% të nevojave reale të kërkuara për këtë program.

- **Mbështetje për Burimet Natyrore**

Në këtë program janë planifikuar fonde buxhetore të nevojshme në mbështetje të politikave lidhur me fushën e menaxhimit të burimeve natyrore që synojnë jo vetëm zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, por dhe në rritjen e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2022 ka pakësim të tavanit buxhetor me 41.6 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit të vitit 2021. Ky pakësim konsiston në:

- pakësim të shpenzimeve korrente me 27.4 milion lekë;
- pakësimin të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm me 14 milion lekë.

Për vitin buxhetor 2022, brenda këtij programi, në shpenzimet korrente përfshihen edhe shpenzimet e administrimit jo vetëm për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, por edhe për AKSEM.

Projekt ligji i buxhetit 2022 ka planifikuar një fond prej 134.3 milion lekë, në ndryshim nga kërkesa dhe nevoja reale që ka ky program për shpenzime korrente prej 235 milion lekë.

Kërkohej një rritje e tavanit buxhetor në vlerën rreth 100,6 milion lekë për shpenzimet korrente. Nëse kjo kërkesë nuk përmbushet këto dy institucione nuk kanë fonde për paga e sigurime shoqërore dhe për asnjë veprimtari tjetër administrative.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë parashikuar në vlerën 91 milion lekë, e konsiston në financimin e politikave ekzistuese, për institucionet:

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore,
- Sekretariati për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI),
- Konservime per Albminera, Albbakër, Albkrom.

- **Planifikim Menaxhim Administrim**

Programi “Planifikimi urban” harton, mbështet dhe zbaton procese dhe politika për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, kontrollin e territorit, mbetjet urbane, si dhe mbështet zhvillimin e vendit në nivel bashkie dhe rajoni, sipas fushave të përgjegjësisë; harton, mbështet, financon dhe zbaton projekte në fushat e mësipërme.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2022 shpenzimet korrente janë shtuar në vlerën 30.4 milion lekë që përfshijnë fondet për Arkivin Qëndror Teknik të Ndërtimit dhe për Agjencinë Shtetërore të Shpronsimeve, paga, sigurime shoqërore e shpenzime operative.

Projektligji “Për Buxhetin e vitit 2022” mbulon 100% të nevojave reale të kërkuara për këtë program.

- **Mbështetje për rrjetet e Komunikacionit**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për programin “Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit” është e angazhuar plotësisht për të avancuar me zhvillimin e infrastrukturës digjitale broadband, si dhe prioritet ka realizimin e qëllimit dhe arritjen e objektivave të politikës së programit, për funksionimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative, rritjen e standardeve dhe performancës së punës së tyre.

Në Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025 është parashikuar dhe ngritja e Zyrës Kompetente për Broadband (BCO) sipas praktikave në vendet e Bashkimit Evropian.

Krijimi i BCO-së është i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve për zhvillimin e infrastrukturës digjitale broadband.

Projektligji i buxhetit të vitit 2022 siguron mbështetje buxhetore projektet prioritare të programit nga ku përmendim

1. Zhvillimi Rajonal i Broadband "Asistencë teknike - Projekti pilot 1 - për zonën e veriut”;
2. Zhvillimi Rajonal i Broadband "Asistencë Teknike - Projekti pilot 2 - për zonën e Jugut;
3. Zhvillimi Rajonal i Broadband "Asistencë teknike - Projekti i Atlasit të broadband”.

➤ **Diskutimi në Komision**

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2022 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, u përqëndruan kryesisht në:

- mbulimin me financim për projekte të ndryshme infrastrukturore, si dhe proporcionaliteti gjeografik i projekteve infrastrukturore;
- problematikat e mirëmbajtjes së rrjetit rrugor;

- menaxhimin e mbetjeve urbane dhe problematikat e tyre si në grumbullim, venddepozitime apo incineratorë, kryesisht në qarqe që nuk kanë fare infrastrukturë;
- problematikat në furnizimin me ujë dhe projektet në infrastrukturë e ujësjellës – kanalizime dhe përfitimi i zonave rurale prej tyre;
- infrastruktura e nevojshme rrugore, energjetike, dhe ujësjellës – kanalizime në zonat me përparësi turizmin dhe ato që po promovohen rishtazi;
- investimet në sektorin e energjisë dhe diversifikimin e burimeve të energjisë;

Ministria Balluku, iu përgjigj pyetjeve të deputetëve duke i sqaruar për të gjitha shqetësimet e ngritura prej tyre.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 22 nene.

- ***Përfundime***

Gjatë diskutimeve, deputetët, pasi u njohën me nevojat buxhetore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe për ato çështje për të cilat u ngrit nevoja për t'u mbështetur me fonde shtesë apo rregullim i brendshëm i tyre, u shprehën të gatshëm që t'i trajtojnë ato gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”.

Pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2022 për secilën nga ministritë e mësipërme, në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash u shpreh dakord në parim me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.

Alqi BLLAKO

Arben PËLLUMBI

Relator

Kryetar



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 18.11.2021

Dokument parlamentar

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022” (nen për nen)

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, pas miratimit në parim në seancë plenare, nisi shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, në mbledhjen e datës 18 nëntor 2021.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit nen për nen të projektbuxhetit të vitit 2022 ishin Zv/Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Vasilika Viero dhe përfaqësues të tjerë të kësaj Ministrie, përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Zv/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Znj. Vilma Bello e përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2022” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë diskutimeve, Komisioni u njoh edhe njëherë me disa kërkesa për lëvizje dhe shtesë fondesh të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe me kërkesën për një shtesë fondit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Kërkesat për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

1. Zv/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit sqaroi deputetët se nisur nga problematikat e evidentuara ndër vite për mosmenaxhimin me efikasitet të mbetjeve nga Bashkitë e krijuara pas ndarjes territoriale dhe problemet e trashëguara nga ish komunat, qeveria kërkon t'i vijë në ndihmë pushtetit vendor nëpërmjet fondit të pakushtëzuar për trajtimin e mbetjeve, në vlerën 500.000.000 lekë, me qëllim që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të mund të përmbushin funksionet e tyre në menaxhimin e mbetjeve.

Për këtë qëllim u kërkuar mbështetja e Komisionit për shpërndarjen e fondit të pakushtëzuar në vlerë 500.000.000 lekë, për 21 bashki të Zonës së Mbetjeve Shkodër-Lezhë, Tiranë-Durrës dhe Elbasan, që kanë një marrëveshje bashkëpunimi me impiantet/landfillet sanitare të licencuara për menaxhimin e mbetjeve.

Deputetët, pasi u njohën me tabelën e shpërndarjes së këtij fondi, diskutuan në lidhje me shpërndarjen e këtij fondi dhe me kriteret e përzgjedhjes së këtyre Bashkive, si dhe mbështetën kërkesën për shpërndarjen e këtij fondi shtesë për Bashkitë, pasi kjo do ndihmojë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në menaxhimin me efikasitet të mbetjeve, duke u siguruar atyre fondet e nevojshme për transportin e mbetjeve në impiante e landfille në zonat e Shkodrës, Tiranës dhe Elbasanit.

2. Në programin Administrimi i Pyjeve kërkohet shtesë fondi prej 20 milionë lekësh në llogarinë 600 (Paga), pasi nga përlllogaritjet për zërin paga e sigurime shoqërore, mbështetur në numrin e punonjësve sipas organikës së Ministrisë, ka një mangësi fondesh në këtë masë.
3. Gjithashtu, kërkohen dhe ndryshime fondesh brenda tavaneve të programeve buxhetore të Ministrisë.

Kërkesat për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Përfaqësuesit e MIE-s kërkuar që në programin “Mbështetje për Burimet Natyrore” të shtohet një fond prej 100.6 milionë lekësh si shpenzime korente. Brenda këtij programi, në shpenzimet korrente përfshihen edhe shpenzimet e administrimit jo vetëm për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), por edhe për Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM). Duke qenë se një funksion i AKSEM ka kaluar në SHGJSH, por nuk është parashikuar fondi i pagave për personelin, del si domosdoshmëri shtimi i një fondi prej 100.6 milionë lekësh si shpenzime korente.

- ***Ndryshime të projektligjit***

Pasi u njoh me nevojat e mësipërme të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioni i miratoi ato me shumicë votash, si më poshtë:

I. Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

1. Në programin e mjedisit, në llogarinë 604 (Transferta korrente të brendshme) fondi prej 500 milion lekë të zbritet nga buxheti i MTM dhe të kalojë në fondin rezervë të buxhetit të shtetit.

2. Në programin Administrimi i Pyjeve, në zërin paga e sigurime shoqërore, mbështetur në numrin e punonjësve sipas organikës së MTM-së, shtesë fondi prej 20 milion lekë në llogarinë 600 (Paga).
3. Brenda tavaneve të programeve buxhetore për MTM-së ndryshimet si më poshtë:
 - Në shpenzimet korente, në programin “Mbrojtja e Mjedisit”, në llogarinë ekonomike 602 (mallra dhe shërbime) të zbriten 18 milionë lekë dhe të shtohen në programin “Zhvillimi i Turizmit” në llogarinë ekonomike 602 , 18 milionë lekë.
 - Në shpenzimet kapitale, në programin “Administrimi i Pyjeve”, nga kapitulli 4 (TVSH) të zbriten 40 milionë lekë dhe t’i shtohen kapitullit 1 (Investim).
 - Në shpenzimet kapitale, në programin “Zhvillimi i Turizmit”, nga kapitulli 3 (kosto lokale) të zbriten 4,5 milionë lekë, nga kapitulli 4 (TVSH) të zbriten 15 milionë lekë, për t’u shtuar në kapitullin 1 (investime), në total 19.5 milionë lekë.
 - Në shpenzimet kapitale në programin “Mbrojtja e Mjedisit”, nga kapitulli 3 (kosto lokale) të zbriten 15 milionë lekë, nga kapitulli 4 (TVSH) të zbriten 15 milionë lekë, për t’u shtuar në kapitullin 1 (investime), në total 30 milionë lekë.

II. Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Në programin “Mbështetje për Burimet Natyrore” rritje e tavanit buxhetor në vlerën rreth 100,6 milionë lekë për shpenzimet korrente (paga, sigurime shoqërore, veprimtari administrative).

Komisioni i propozon Komisionit përgjegjës miratimin dhe reflektimin e tyre në nenet përkatëse të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”.

• Përfundim

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash, vendosi miratimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”.

Alqi BLLAKO

Arben PËLLUMBI

Relator

Kryetar